



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:248818

Datë: 21.02.2024

Numri i dokumentit: 05355466

CP.nr.105/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përbarimore të kreditorëve S. A., F.I., B. I., A. H., S. M., G. P., B.M., B.V., M. P., R. M., F. O., H. A., E.S. S. P., A. A., te cilët me autorizim i përfaqëson avokat Gazmend Ismajli me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Ndërmarrja “T.” sh.a. me seli ne Mitrovice, lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përbarimor - Aktgjykimi C.nr. 1044/2019, te datës 10.02.2019, të lejuar me aktvendimin për përbarim CP 105/22, te datës 08.03.2022, jashtë seance gjyqësore, me datën 21.02.2024 morri ketë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore e udhëhequr sipas shenjës CP.nr.105/2022, e iniciuar nga kreditorët S. A., F.I., B. I., A. H., S. M., G. P., B.M., B.V., M. P., R. M., F. O., H. A., E.S. S. P., A. A., ndaj debitorit Sh. a “T.”, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditorët e përbarimit S. A., F.I., B. I., A. H., S. M., G. P., B.M., B.V., M. P., R. M., F. O., H. A., E.S. S. P., A. A. përmes te autorizuarit te tyre avokat Gazmend Ismajli me seli ne Mitrovice, kane paraqitur propozim për përbarim në bazë të dokumentit përbarimor - Aktgjykimi C.nr. 1044/2019, te datës 10.02.2019.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përbarimit, me aktvendimin CP.nr.105/22, te datës 08.03.2022, ka lejuar përbarimin ndaj debitorit Ndërmarrja “Trepça” Sh. a. –me seli ne Mitrovice.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP.nr.105/22, te datës 22.06.2022, është bere i ekzekutueshëm, banka ... me dt. 04.07.2022, me parashtrere ka njoftuar gjykatën se debitori i përbarimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
CP.nr.105/2022 më datë 21.02.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.